



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PER DREJTESI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

Për: Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

**Nga: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)
Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)**

Data: 08/05/2018

Thirrje për zbatimin e standardeve të transparencës dhe shmangies së nepotizmit në Universitetin e Prishtinës në konkursin për zgjedhjen e personelit akademik për pozita të reja

I nderuar Z. Ministër Bytyqi,

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) së bashku me Institutin të Kosovës për Drejtësi (IKD) muajin e kaluar i ka drejtuar Këshillit të Etikës të UP-së një kërkesë për sqarimin e standardeve që UP përcakton në lidhje me zbatimin e konkursit publik. Letra me numër portokolli Nr. 1/839 *“Kërkese në lidhje përcaktimin e standardeve të transparencës dhe shmangies së nepotizmit në Universitetin e Prishtinës në konkursin për zgjedhjen e personelit akademik për pozita të reja”* u bazua në shqetësimet e vazhdueshme në lidhje me fenomenin e nepotizmit në zgjedhjen e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës. Kjo kërkesë po ashtu u bazua në Opinionin e Avokatit të Popullit Nr.481/2018 të datës 16/03/18 në lidhje me *Parandalimin e nepotizmit në Universitetin e Prishtinës, drejtuar z. Marjan Dema, Rektor i Universitetit të Prishtinës dhe z. Shyqyri Bytyqi, Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.*

Mbi këto fakte dhe nga interpretimi i bazës ligjore, Statutit, Kodit të Etikës, Rregullores për zgjedhjen e personelit akademik në UP, iu drejtuaam organeve të Universitetit, në veçanti Këshillit të Etikës me qëllim që të bëjnë publike të masat dhe standardet e shkruara në lidhje me parandalimin e nepotizmit në procesin e punësimit të personelit akademik.

Këshilli i Etikës në përgjigje të Opinionit të Avokatit të Popullit dhe kërkesës së Instituteve tona, në mbledhjen e mbajtur më datë **2.05.2018** ka nxjerrë Udhëzuesin për standardet dhe parimet

etike të Universitetit të Prishtinës në lidhje me shmangien e nepotizmit dhe parandalimin e konfliktit të interesit në procedurat e zgjedhjes së stafit akademik për pozitat e reja, sipas institucionit të konkursit publik. Udhëzuesi me numër protokollar **1/210** i hartuar nga Këshilli i Etikës i merr parasysh rekomandimet e Opinionit të Avokatit të Popullit dhe si i tillë paraqet në mënyrë të përmbledhur disa nga masat dhe standardet kryesore të etikës që Universiteti i Prishtinës i zbaton me qëllim të parandalimit të nepotizmit në lidhje me punësimin e personelit akademik në pozita të reja, përkatësisht punësimin për herë të parë.

Fillimisht, nxjerrja e këtij udhëzuesi i legjitimon shqetësimet tona për fenomenin e nepotizmit në zgjedhjen e personelit akademik në UP, por po ashtu është edhe një indikator i gatishmërisë së Këshillit të Etikës për të ndihmuar në zhdukjen e këtij fenomeni. Duke e mirëpritur këtë udhëzues, ne ju bëjmë thirrje Juve si ministër i Arsimit të bëni atë që e keni në përgjegjësi për t'i pasur parasysh dhe zbatuar standardet dhe parimet etike të Universitetit të Prishtinës në lidhje me shmangien dhe parandalimin e konfliktit të interesit në procedurat e zgjedhjes së personelit akademik për pozita të reja.

Kjo është një mundësi e mirë që të tregoni vullnetin Tuaj për rritjen e transparencës dhe parandalimin e nepotizmit në Universitetin e Prishtinës në lidhje me zbatimin e konkursit për rekrutimin e personelit akademik për pozita të reja, ruajtjes së standardëve të etikës dhe integritetit akademik në UP. Deri më tani, Ju si ministër i Arsimit, keni treguar se jeni të vullnetshëm të ndërmerrni hapa drejt përmirësimit të nivelit të arsimit në Kosovë dhe ky është po ashtu një rast adekuat përmes së cilit mund të ndikoni në ngritjen dhe ruajtjen e integritetit akademik të UP-së.

Duke i pasur parasysh këto, Ju bëjmë thirrje t'i keni parasysh këto standarde të përmbledhura në Udhëzuesin e Këshillit të Etikës të UP-së dhe të mos lejoni që ato të cenohen gjatë rekrutimit të stafit akademik në konkurset publike me qëllim të parandalimit të nepotizmit, konfliktit të interesit, respektimit të parimit të barazisë dhe shmangien e ndikimit të drejtpërdrejtë dhe indirekt në procesin e rekrutimit të personelit të ri, nga ana e stafit akademik të brendshëm të cilët janë në lidhje familjare me kandidatët që aplikojnë në konkurs.

Me respekt,

Burim Ejupi

Drejtor Ekzekutiv INDEP

Betim Musliu

Drejtor ekzekutiv IKD